



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 180, Datë 06.11.2020

“MBI

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMIÇAN” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1860 MW”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, Nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 14 pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.118/2 Prot, datë 02.11.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” shpk., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 154, datë 18.09.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan” me kapacitet të instaluar 1860 kW.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje në datën 22.09.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. Me shkresën nr. 1073/1 prot., datë 22.09.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1073/2 prot., datë 28.09.2020, si dhe me shkresën nr. 1073/4 prot., datë 26.10.2020 dhe nr. 1073/5 prot., datë 28.10.2020, ka plotësuar kryesisht dokumentacionin e munguar.
- Në nenin 92 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.
- Në pikën 3 të nenit 14 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 dite pune.*
- Marrja e shpjegimeve dhe përlllogaritja e afateve të hyrjes në fuqi të kontratës së qirasë si dhe lejes mjedisore, në varësi të kohës së miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe kohëzgjatja dhe afatet e rinovimit të lejes se ujit të disponuar nga aplikuesi, kërkojnë zgjatjen e afateve procedurale për qëllime të shqyrtimit të kësaj kërkesë për licencim.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 10 ditë afatin procedural të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamëçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes , të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI